

REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS

01/Br. Prot. IZLAZNI - DALËSE
Nr. Prot. 01-020/08-2458/22
Br. str. /
Nr. l fq. /
Datum 02.03.2022.
Data
ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština štrpce
Komuna e Shtërpcës
Municipality of Strpce



Në bazë të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpcës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më datën 25.02.2022 ka miratuar këtë :

VENDIM
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË QEVERISJESË KOMUNALE PËR PERIU DHËN
JANAR - DHJETOR 2021

1. Miratohet raporti i qeverisë komunale për periudhën janar - dhjetor 2021, sipas tekstit i bashkangjitur me këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .



Kryesuesi i Kuvendit
Predrag Grbic

REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVES
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTERPCES

IZLAZNI - DALËSE

03/Bt.Prot. 02-030/07-1872/22
Nr.Prot.
Br.str.
Nr / fq.
Datum 16.02.2022.
Data

ŠTRPCE - SHTERPCË

Opština Štrpce – Kancelarija Predsednika



Komuna e Shtërpçës – Zyra e Kryetarit

Štrpce Municipality – Mayor's office

Data/ Datum/ Date	Dhjetor 2021
Ref.	

Për/Za/ For:	Kuvendi Komunal Shtërpçë
Përmes/Preko/ Through	Arkivës
Nga/Od/ From:	Kryetari Dalibor Jevtic
Lënda/Predmet/ Subject:	Raporti gjashtëmujori punës së Kryetarit – II janar -dhjetor 2021



Të nderuar këshilltarë,

Raporti për punën e kryetarit të komunës është bazua në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara me rregulloret dhe vendimet e organeve kompetente, planifikimi, realizimi i projekteve dhe kryerje e obligimeve të tjera të përfshira me Planin e Punës për vitin 2021.

Kryetari i Komunës dhe Administrata Komunale kanë drejtuar politikën e zbatimit të rregulloreve brenda kompetencës së tyre, kanë drejtuar në drejtimin të arritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të plotë, duke e bazuar punën e tyre në parimet e ligjshmërisë, respektimin e afateve, ekonominë, respektimin e kornizave buxhetore dhe arritjen e rezultateve me të cilat justifikojnë veprimtarinë e komunitetit lokal. Planifikimi i zhvillimit lokal, duke siguruar burimet e nevojshme materiale dhe njerëzore, kanë siguruar në mënyrë të konsiderueshme përparimin e të gjithë komunitetit.

Në periudhën raportuese, përveç të gjitha detyrave dhe çështjeve të tjera, vëmendja prioritare u përqendrua si në vijim:

- realizimi i buxhetit të Komunës
- ligjshmëria në punën e Administratës Komunale
- Përmirësimi i kushteve të biznesit, stimulimi i projekteve në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe turizmit
- modernizimi i objekteve arsimore
- përmirësimi i kushteve të punës të institucioneve shëndetësore
- investimi në zhvillimin e burimeve njerëzore
- forcimi i sektorit social

- Përmirësimi i efikasitetit të punës në fushën e rregulloreve të planifikimit hapësinor, zhvillimin dhe përmirësimi i marrëdhënieve me publikun dhe transparenca në punën e Administratës Komunale, dhe bashkëpunimi me sektorin joqeveritar
- zbatimi i vazhdueshëm dhe inovacioni në komunikim me publikun
- zgjidhja e problemeve dhe ndihma e qytetarëve të rrezikuar social duke ofruar shërbime cilësore
- afirmimi i projekteve të organizatave rinore dhe mbështetja e projekteve për punësimin e të rinjve

Në përmbushjen e detyrave prioritare, por edhe në kryerjen e të gjitha obligimeve të tjera, janë evidentuar përpjekjet në ruajtjen e nivelit të arritur të zhvillimit dhe mund të them lirisht se komuna jonë është përfshirë në radhët të komuniteteve lokale që mund të ofrojnë shërbim cilësor për qytetarët me dijen e tyre me punë dhe ekspertizë. Treguesi më i mirë i punës së suksesshme është kënaqësia e qytetarëve.

Përveç kësaj punës së Komunës, dua t'ju tregoj këshilltareve edhe se:

Ne jemi të vetëdijshëm për faktin se po përballemi me një pandemi që ka tendencë të përhapet me shpejtësi, ku pas vetes e lenë pasoja të paparashikueshme. Organet qendrore dhe lokale kanë prezantuar masa mbrojtëse që janë të zakonshme në kohë pandemie dhe emergjencash. Udhëheqja komunale, së bashku me shtabin e krizës dhe faktorët të tjerë përkatës, monitorojnë situatën aktuale në baza ditore dhe në përputhje me rrethanat marrin vendime adekuate në mënyrë që të parandalojnë përhapjen e mundshme të virusit.

Si ekip menaxhues i Komunës së Shtëpcës, ne jemi të gatshëm t'ju përgjigjemi të gjitha pyetjeve të qytetarëve tanë. Qëllimi jonë është krijimi i një jetesë së kualitative, vëmendja jonë është fokusuar në përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve në komunë. Fakti është që ne dëshirojmë që qytetarët të njohin punën dhe angazhimin e udhëheqjes komunale, gjëra të cila gjithashtu na motivon që të vazhdojmë të punojmë dhe në mënyrën më efikase i zgjidhmi problemet dhe pengesat që kemi, për një jetë më të kualitative dhe më të mirë për qytetarët. Falë punës së përkushtuar dhe mbështetjes së partnerëve dhe bashkëpunëtorëve, ne kemi arritur të justifikojmë besimin që kanë për neve.

Ne kemi përqendruar të gjithë vëmendjen tonë në gjetjen e mundësive për të inkurajuar vetëpunësimin, duke investuar në bujqësi, ashtu edhe duke mbështetur bizneset e vogla familjare. Ne kemi mbështetur ata njerëz që janë të angazhuar në kultivimin e mjedrës, fermerët, prodhuesit e mjaltit dhe zejtarët e profileve të ndryshme.

Kur bëhet fjalë për çështje të identitetit, udhëheqja komunale dhe administrata i kanë kushtuar një pjesë të madhe të punës së tyre në afirmimin të vlerave, promovimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve, duke respektuar dallime.

Zhvillimi i turizmit prodhon efekte të shumta pozitive ekonomike, kështu që Komuna në të ardhmen dhe në të kaluarën do të angazhohet plotësisht për gjetjen e mënyrave për përmirësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj degë ekonomike, zbatimi i së cilës do të mundëson

mundësi të mëdha punësimi për njerëzit lokalë dhe të gjithëve, me qëllimin e përmirësimit të afatgjatë, të cilësisë së jetës e qytetarëve, tërritjes së numrit të vizitave dhe kënaqësisë së turistëve

Zyra për Informimin Publik ka përmirësuar ndjeshëm punën e saj dhe ka informuar në mënyrë të adekuat qytetarët tanë për punën e legjislativit dhe ekzekutivit të komunës. Në këtë mënyrë, qytetarët kishin mundësinë të përcjellin punën e Kuvendit të Komunës dhe Administratës komunale dhe të informoheshin në kohën e duhur për të gjitha projektet dhe konkurset e rëndësishme komunale.

Situata e sigurisë në komunën tonë në periudhën e raportimit ka qenë në përgjithësi mirë. Si dhe bashkëpunimi i mirë me Stacion Policor të Kosovës së Shtërpsës. Gjithashtu, ka punuar në mënyrë efikase dhe Komiteti Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Nga aspekti politik, më duhet të tregoj atë për të cilën jam shumë krenar, me përgjegjësi po them se ne jemi një nga komunat e pakta si shembull i bashkëjetesës së mirë të serbëve dhe shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera, sepse dallimet respektohen dhe toleranca është e përfaqësuar gjerësisht, e cila është një parakusht themelor për një jetë të mirë..

Administrata e Përgjithshme

Misioni i Drejtorisë për Administratë është zbatimi i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve tjera që aplikohen në Administratë, Udhëzimet Administrative të nivelit qendror, Statutit të Komunës së Shtërpsës dhe akteve tjera komunale të aprovuara nga Kryetari I Komunës dhe Kuvendi i Komunës. Drejtoria e Administratës, kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Shtërpsës.

Në vitin 2021, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka vazhduar të kryej detyra të parapara dhe duke ofruar shërbimin e punëve me palë e kryen përmes zyrës pritëse dhe sektorëve tjerë përkatës.

Shërbimit Profesional për punët e Kuvendit – me sukses ka përgatitur dhe krijuar kushte teknike për mbajtjen e seancave të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu, për të gjitha kuvendet e mbajtura, ajo ka dorëzuar rregullisht raport në Ministrinë e Administratës, duke përmbushur obligimet ligjore që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Zyra e Shërbimeve për Qytetarë

Qendra ofron shërbime për qytetarët përmes zyrës së pritjes ku kryhet: pranimi i lëndëve nga palët, përpunimi i tyre, ofrimi i ndihmës profesionale për palët e interesuara. Gjithashtu, kjo Qendër tani ofron shërbime për pranimin dhe shpërndarjen e postës në përputhje me ligjin për procedurat administrative

Gjatë kësaj periudhe, përmes zyrës së pranimit janë pranuar lëndë si më poshtë:

Shkurtesa	Përshkrimi	Pranuar	Ne Proces Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	ar	Totali
KK	Kuvendi Komunal (Kuvendi, Komitetet dhe të gjitha shërbimet profesionale të Kuvendit)	2	6	80	0	0	0	3	0	91
ZK	Zyra e Kryetarit (Kryetari, Nënkryetarët, Zyra e Personelit, Zyra e Prokurimit)	20	101	948	0	0	0	3	0	1072
DAP	Drejtoria për Administratë të Përgjithshme	24	1189	2501	0	0	0	10	5520	9244
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	17	723	2149	0	0	0	6	0	2244
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Turizëm, Bujqësi dhe Pylltari	2	18	33	0	0	0	1	0	54
DPRUMA	Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	15	396	266	0	0	0	14	0	691
DGJK	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	25	996	3256	0	0	0	11	0	4288
DAKRS	Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit	6	31	415	0	0	0	1	0	453
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	3	46	115	0	0	0	2	0	166
DSHPMSH	Drejtoria për Shërbime Publike,	2	26	65	0	0	0	1	0	94

	Mbrojtje dhe Shpëtim										
DI	Drejtoria e Inspektimit	4	54	73	0	0		0	1	0	132
		113	1312	8449	0	0	0	0	31	4634	14539

Sektori i Shërbimit të Ofiqarisë- i cili punon në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme,

Sektori i Gjendjes Civile me stafin e tij në periudhën Janar-Dhjetor 2021, ishte angazhuar në ekzekutimin dhe pranimin e kërkesave, si dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Janar – dhjetor 2021	Vërtetim nga Arkiva	Ekstrakte të lindjes	Certifikata të lindjes	Certifikata të martesës	Certifikata të vdekjes	Certifikata të gjendjes martesore	Aktiviteti për regjistrimin e mëvons hëm	Deklarata familjare	Certifikata të shtetësisë	Vendbanimi	Procesverbal për pranimin atësisë	Dëshmi për v
sasia	204	4859	557	727	570	137	16666		44	492	22	42
Gjeteje lëndë të përfunduara	8336 lënda											

Zyra për barazi gjinore: Gjate periudhës janar-dhjetor 2021, zyra për barazi gjinore ka krye detyrat e punës dhe ka qenë angazhuar në aktivitete si në vijim:

- Takimet për persona të riatdhesuara
- Konferencë me rastin e 8 marsit, tema Grua në vendin e punës në Kosovë
- Shumë takime, debate publike dhe trajnime në temën pozicioni e gruas në jetën publike, politike, etj.
- Takime të shumta me përfaqësues të Zyrës së Avokatit të Popullit.
- Trajnime për temën diskriminimin, aftësitë drejtuese dhe udhëheqëse për gratë, etj.
- Puna në programin për pranim-logjistikë, ku janë përfunduar gjithsej 445 lëndë.
- Trajnim për gratë në bashkëpunim me Forumin për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik, ku tema ishte fuqizimi i grave nga komunitetet pakicë në një mjedis ekonomikisht të qëndrueshëm.
- Promovimi i dallimit dhe barazisë në Kosovë.
- Përmirësimi i pjesëmarrjes të grave në vendimmarrje gjatë pandemisë COVID 19.
- Ditët e hapura për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë.

- Punësoria për qasjen në drejtësi për komunitetin LGBT.
- Hapja e fushatës 16 ditët e aktivizimit.
- Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Komunës së Novobërdës për hapjen e strehimoreve për viktimat e dhunës në familje. Strehimoren do ta shfrytëzojë edhe komuna e Shtërpçës.
- Pjesëmarrja në takimet e Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi.
- Në bashkëpunim me shoqatën e grave “Nas Dom”, u hap konkursi për projektin „Feminizëm për drejtën Fillestare –Gruas apo Gjykimi.”

Përdorimi i veturave zyrtare: –Drejtoria është duke bërë mbikëqyrje për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve të komunës, në përputhje me Rregulloren Komunale për përdorimin e veturave zyrtare.

Shërbimet Teknike- Në këtë sektor kemi punuar në të gjitha punët të parashikuara e lidhur me mirëmbajtjen e ndërtesës së komunës; sigurimin i objekteve të Komunës; mirëmbajtja e higjienës në objektin; shërbime hoteliere nga bufeja e Komunës, për nevojat e zyrtarëve të Komunës; mirëmbajtja teknologjisë informative, organizimi dhe shfrytëzimi i veturave zyrtare dhe mundem me thonë që kemi arritur rezultate relativisht të mira.

Menaxheri i IT-ës/ Zyrtari për Informim publik për përdhën janar-dhjetor 2021, ka kryer këto punë:

- Mirëmbajtja e përditshme LAN dhe ËAN rrjetit
- Mirëmbajtja e kompjuterëve dhe pajisjeve të përcjellëse në komunën e Shtërpçës
- Mirëmbajtja e PTK-ës, internetit dhe rrjetit telefonik
- Mirëmbajtja e rrjetit qeveritar në bashkëpunim me zyrtarët e IT-së nga MAPL
- Puna në organizimin e debateve publik për buxhetin.
- Puna në organizimin e dëgjimeve publike.
- Hapja e e-mail adresave për zyrtarët komunalë.
- Mbështetje për stafin komunal dhe largimin e problemeve të prishjeve të softuerit dhe harduerit.
- Azhurimi i përditshëm i ëeb-faqes së komunës.

Ajo që është shumë e rëndësishme, të gjitha informacionet si dhe dokumentet e postuara në ëeb-faqe publikohen në të dy gjuhë zyrtare, serbe dhe shqipe.

Buxheti dhe financat

Detyrat kryesore të drejtorisë përcaktohen në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifat dhe Gjobat Komunale Nr.01-16-927 nga data 4 Prill 2012, dekrete dhe udhëzime të tjera administrative nga niveli qendror.

Bazuar në këto dokumente dhe planin e veprimit të paraqitur në fillim të vitit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë vitit 2021 ka kryer këto aktivitete:

Raporti financiar

Më fillimin e vitit 2021 drejtoria për buxhet dhe financa ka punuar në raportin vjetor financiar për vitin 2020. Në bazë të rregullit financiar 07/2011 është bërë raporti ekstrem financiar i cili dërgohet në Ministrinë e Financave, deri më 30 janar, ku, në bazë të këtij raporti, auditim kryhet nga një auditor nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Prishtinë. Përveç raportit të mësipërm, janë përgatitur raporte të brendshme vjetore financiare për vitin 2020, si dhe tri raportet të brendshme për vitin 2021, të cilat përcillen Kuvendit Komunal për shqyrtim.

Auditimi gjatë vitit 2021

- Gjatë vitit 2021 kemi pasur 3 auditime dhe ato nga :
- Zyra e Auditimit të Përgjithshëm, lidhur me raportin vjetor financiar të Komunës së Shtërpçës për përdhën e vitit 2020.
- Zyrat e auditorit të brendshëm lidhur me taksa për biznes dhe
- Zyra e Auditimit të Përgjithshëm, lidhur me raportin vjetor financiar të Komunës së Shtërpçës për përdhën e vitit 2021 .

Gjatë pjesës së parë të vitit 2021, kemi pasur auditimin nga auditoret nga zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Prishtinë, lidhur me raportin vjetor të punës së komunës për vitin 2020. Në qershor ka përfunduar dhe është dorëzuar raporti në të cilin janë dhënë 7 propozime. Ashtu si vitet e kaluara, edhe këtë vit morëm një mendim jo të modifikuar, me përparim domethënës në punën e komunës. Bazuar në raport, është bërë një plan i veprimit, të cilin kemi dërguar zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në fund të qershorit.

Buxheti i komunës së Shtërpçës për vitin 2021

Në bazë të ligjit nr. 07/L-001 Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, komuna e Shtërpçës ka buxhetin fillestar prej 3,643,263€, të hyrave vetanake të planifikuara që kapin shumën prej 414,299€, granti qeveritar në vlerë prej 3,643,263€, Gjatë tremujorit të parë të vitit aktual, kemi pasur rritje të buxhetit për 43,202.41€ të kategorisë pagat dhe mëditje dhe transferimi i shumës së mbetur nga DEMOS-i në vlerën totale prej 7,518.46€ (shuma e cekur është kthye donatorit në bazë të marrëveshjes së nënshkruar, që mjete pa shpenzuar të kthehen), Përveç të

cekurit në gjysmën e parë të vitit kemi një rritje të buxhetit fillestar prej 247,604.17 €, si rezultat i transferimit të të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2020 në 2021, gjithashtu gjatë gjashtëmujorit e parë të 2021, kemi shuma prej 3,449.00 €, donacion nga projekti DEMOS nga Zvicra, në lidhje me performancën e komunës. Gjatë tremujorit të fundit, buxheti është ulur si më poshtë:

- Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 900 €, si rezultat i zvogëlimit të buxhetit në programin buxhetor të Drejtorisë së Inspektimit.

- Në kategorinë e pagave në vlerë prej 129,304,67 €, si rezultat i kursimeve në këtë kategori.

Duke marrë parasysh, buxheti e përmendu më sipër për vitin 2021 është 3,771,629,96 €..

Raportet mujore dhe ndryshimet

Gjatë secilit muaj drejtoria për buxhet dhe financa ka obligim të dorëzimit të listës së obligimeve të komunës, pagesës së tatimit në qira dhe raportin në administratën tatimore, ndryshimet në listat të pagave, alokimi i të hyrave vetanake, etj. Të gjitha punët e cekur më lart janë obligimet ligjore që duhet të kryen në çdo muaj, pa vonesë, përkundër kapacitetit të zvogëluar të punëtorëve për shkak të pandemisë Covid-19, tashmë janë bërë të gjitha më sipër të parashikuara me ligj.

Të hyrat vetanake

Të hyrat vetanake e planifikuara për periudhën 2021 kapin shumën prej 414,299€. Deri 31.12.2021 është grumbulluar 397,106.35€ ose 95,85% nga e planifikuara. Përveç këtyre duhet të përmendet që në shumën e cekur nuk janë përfshirë mjete nga dënimet e policisë, gjykatës dhe hyrat nga pylltaria. Arsyeja e mbledhjes së më të mirë të të hyrave vetanake në krahasim me vitin e kaluar është për shkak të situatës e atëherëshme me pandemi e virusit Covid 19, të gjitha komunat në Kosovë përballen me këtë problem.

Planifikimi, Rindërtimi, Urbanizmi dhe Mbrojtja e Mjedisit

Në fillim të vitit 2021, Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit është angazhuar në përgatitjen e një liste të prioriteteve e projekteve për periudhë 2021-2023, në bashkëpunim më përfaqësuesit të gjitha vendbanimeve në Komunën. Janë përgatitura të detyrat e projektit për fillimin e procedurës së tenderit për përzgjedhjen e një kompanie për përgatitjen e dokumentacionit teknik për projektet e infrastrukturës të planifikuara për zbatim në këtë dhe vitin e ardhshëm.

Është përgatitur dhe dorëzuar dokumentacioni për hapjen e granteve të Ministrisë për Zhvillim Regional, Ministrisë së Administratës dhe Vetëqeverisjes Lokale, si dhe kërkesa për mbështetje financimin e projekteve kapitale janë dorëzuar Ministrisë për Kthim dhe Komunitet dhe tj.

Ka përfunduar realizimi i projekteve kapitale, të cilat kanë filluar në vitin 2020, të financuara nga Ministria e Kthimit dhe Komuniteti:

- Zgjerimi i kapacitetit të rrjetit të furnizimit me ujë në vendbanimin Jazhinc, komuna e Shtërpçës;
- Zgjerimi dhe rregullimi i rrugëve lokale në vendbanimin Shtërpçe;

ku kam qenë angazhuar si menaxherë të kontratës për të monitoruar punën e projektit.

Gjatë vitit 2021 kam qenë i angazhuar si menaxher kontratës për ofrimin e shërbimeve Hartimi i strategjisë për vlerësimin e ndikimit në mjedis, hartimi i hartës zonale për komunën e Shtërpçës. Kontrata për ofrimin e shërbimeve është përfunduar në dhjetor 2021, ku është përgatitur draft dokumenti i Hartës Zonale dhe Strategjisë për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Për të respektuar të gjitha dispozitat ligjore deri në miratimin e Hartës e Zonimit në Kuvendin e Komunës, është e nevojshme të merret miratimi për Planin Zhvillimor të Komunës, ku kërkesat janë dërguar disa herë nga Drejtori i Drejtorisë për PRUZS, Ministria e Hapësirës, Planifikimi dhe Infrastrukturës. Gjatë vitit janë futur dhënat në sistemin PIP (Programi i Investimeve Publike) në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet dhe Financa.

Si anëtar i komisionit për Riintegrim personave tëriatdhësuar kam marr pjesë në takime e komisionit dhe përfaqësuesve të ministrive të ndryshme, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe nevojat. Sipas vendimeve të kryetarit kam qenë anëtar i disa komisioneve për hapjen dhe vlerësimin e ofertave në tenderë.

Para drejtorisë kam punuar në raportimin e menaxhimit të mbeturinave në komunë, si dhe regjistrimin e deponive ilegale në komunën e Shtërpçës. Në koordinim me Drejtorin për Shërbime Publike dhe Ndërmarrjen Komunale e Re, janë mbajtur disa takime me përfaqësues të GIZ-it, ku pritet që të bëhet ndarja e mjeteve financiare/ materiale (kamionë për grumbullimin e mbeturinave, kontejnerë për subjektet afariste, koshi për shtëpia dhe etj.) kompanisë komunale nga GIZ përmes komunës së Shtërpçës.

Gjatë vitit 2021 kam punuar në të gjitha aktivitetet e tjera me urdhër të shefit dhe drejtorit të drejtorisë.

Shërbimi kadrovik

Shërbimi kadrovik në periudhën janar-dhjetor vitit 2021, me qëllim të udhëheqjes më të mirë me resurset njerëzore dhe funksionimit më të mirë të komunës, ka pasur aktivitete të shumta. Me rregulloren për sistematizimin e brendshëm të administratës komunale janë tëparashikuar 112 pozicione, nga ato janë tëpunësuar 107 punëtorë, dhe ka 5 pozicione që janë të lira. Gjatë vitit 2021 është bërë edhe një transferim. Nga numri total i punëtorëve, 70 janë serb dhe 37 shqiptarë. Në administratën komunale punojnë gjithsejtë 27 femra dhe 80 meshkuj. Është bërë edhe analiza për nevojat e kuadrove, është punuar plani i pranimi nëshërbyesve civil dhe plotësimin e vendeve të punës mbi aktin e sistematizimit, varësisht nga nevoja e punës dhe mjeteve financiare në dispozicion të parapara me buxhet për këto qëllime.

Përveç monitorimit tëpërditshëm dhe kontrollit të punës tëgjithë drejtorive të komunës , evidentimit të rregullt të gjitha llojeve të mungesave dhe pushimeve, lëshimii aktvendimeve dhe marrjes së akteve tjera juridike, si dhe azhurnimit dhe ruajtjes së dosjeve personale të shërbyesve civil, respektimii orarit të punës, zbatimit të procedurave për pranim në shërbimin civil, procedurave disiplinore, ka pasur edhe aktivitete tjera, veçanërisht në organizimin e punës për shkak të pandemisë së virusit COVID 19, ku ishte e nevojshme të organizohej funksionimi i të

gjitha drejtorive dhe zyra komunale me respektimin e masave parandaluese të Qeverisë së Kosovës, Institutit të Shëndetit Publik dhe Shtabit Komunal të Emergjencave..

Përveç të cekurës , janë bërë kontrollet dhe mbikëqyrja ditore e punës së drejtorive komunale, mbajtja e evidencave për të gjitha llojet e lëndëve, dosjet personale të punonjësve, respektimi i orarit të punës, rastet mbi ankesat kundër vendimeve në fushën e marrëdhënieve të punës, zbatimi i procedura për pranimin në shërbimin civil.

Shërbimi kadrovik duke respektuar Ligjin për Shërbimin Civil Nr. 03 / L-147, në bazë të nenit 80, ka formuar dy komisione: Komisionin për Ankesa dhe Komisionin Disiplinor, të cilët me ligj zgjidhin mosmarrëveshjet dhe zhvillojnë procedura disiplinore.

Shërbimi kadrovik bazuar në vlerësimin e nevojave të nëpunësve civilë për zhvillim profesional si dhe në bazë të planeve individuale të trajnimit, ka zhvilluar një plan të përgjithshëm trajnimi për të gjithë punonjësit në institucion, i cili gjithashtu është dorëzuar të MAP / DAJU.

Gjatë vitit 2021, Shërbimi i Personelit shpalli 5pozicione për vendet të lira pune.

Shërbimi kadrovik do të vazhdojë të punojë në rritjen e edukimin profesional të punonjësve në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, bazuar në ndërtimin e një administrate profesionale dhe efikase, në përputhje me standardet evropiane, duke respektuar parimet themelore të shërbimit civil.

Zyra e auditivit të brendshëm

Aktivitete të cilat e ka realizuar në vitin 2021 Zyra e auditivit të brendshëm janë të përkrahura në ligjin për auditimin të brendshëm nr.06/L-021 dhe të gjitha më qëllimin e rritjes së efikasitetit të punës së subjekteve të shërbimit publik për të rritur nivelin e shërbimeve të cilët afrohen shfrytëzuesit dhe qytetarëve të komunës.

Gjatëperiudhës janar-dhjetor e vitit 2021 në bazë të programit vjetor të punës janë bërë5 auditime dhe ato:

- Sistemi i kontrollit të brendshëm gjatë zbatimit prokurimit publik
- Sistemi i kontrollit të brendshëm gjatë zbatimit menaxhimit të taksave të biznesit
- Sistemi i kontrollit të brendshëm gjatë zbatimit drejtimit të automjeteve zyrtare
- Sistemi i kontrollit të brendshëm gjatë nënshkrimit të aktit të emërimit
- Sistemi i kontrollit të brendshëm për shpenzimin e mjeteve për mallra dhe shërbime në Drejtori e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.
- Sistemi i kontrollit të brendshëm gjatë menaxhimit të të hyrave në kujdesin primar shëndetësor

Në bazë të auditimit të brendshëm numri i rekomandimeve, të dhëna në raportin janë26 dhe ato janë :

- Rekomandime të zbatuara6
- Rekomandime të zbatuar pjesërisht.....10

- Rekomandime pa zbatuara.....10

Rekomandime pa zbatuara të cilët janë dhen në raportin, dhe nuk janë zbatuar, do të zbatohen gjatë vitit 2022, siç është cekur në planin aksionar e udhëheqësit e drejtorisë ku është bërë auditimi. Arsye e pamundësie së zbatimit e shpejt e rekomandimeve është që proceset e punës të cilët kanë filluar për zbatim e rekomandimeve kërkon më shumë kohë për të realizuar të gjitha rekomandime plotësisht.

Prokurimi publik

Në bazë të ligjit për prokurimin nr.04/L-042, zyra e prokurimit ka udhëheqë të gjitha procedurat e prokurimit në pajtim me ligjin e prokurimit duke filluar nga hapja e ofertave deri të dhënia e kontratës.

Për periudhën e raportimit, par e vitit 2021. Zyra e prokurimit ka iniciuar 36 procedura të prokurimit në total dhe ato:

- Një furnizim me vlerë të lartë për furnizim,
- 18 procedura të furnizimit me vlerë të mesme, nga të cilat 2 për punë, 8 për shërbime, 8 për furnizim.
- Kuotimi i çmimeve ka pasur 4 procedura, dhe ato për shërbime.
- Janë iniciuar 12 procedura të furnizimit me vlerë minimale, vlera e të cilave nuk kalon 1000€

Për një procedurë të prokurimit, kushti i tenderit ishte tenderi më i favorshëm ekonomik, ndërsa në procedurat e tjera të prokurimit kushti i tenderit ishte çmimi më i ulët.

Gjatë vitit 2021 është zhvilluar një procedurë për shitjen e pyllit, ku kushti i tenderit ka qenë çmimi më i lartë.

Gjatë vitit 2021, Zyra e Prokurimit Publik ka punuar në plotësimin e nevojave të komunës, duke paguar faturat e operatorëve ekonomikë.

ZYRA PËR KOMUNITETIN DHE KTHIM

Komuna e Shtërpçës në bazë të Rregullores Nr 2010/02 të Qeverisë së Kosovës ka formuar një zyrë komunale për komunitete dhe kthim më datën 21.04.2011, me vendimin të kryetarit të komunës nr.02. 179 dhe me rekomandimin e Komitetit për Komuniteteve të Kuvendit Komunal të Shtërpçës 01 nr. 1133 e datës 27.09.2010, është parashikuar që ZKK ka dy pozicione: 1. Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe 2. Koordinator për kthim.

Të drejtat e komuniteteve dhe qasja në shërbimet: Kur bëhet fjalë për të drejtat e komuniteteve, të gjitha komunitetet në komunën e Shtërpçës janë trajtuar në mënyrë të barabartë të bazuara në qasjen e tyre në shërbimet e ofruara për qytetarët.

Kthimi: Sa i përket kthimit, koordinator i ZKK rregullisht kryen pranimin, regjistrimin dhe procedimin e kërkesave e të kthyerve dhe personave të zhvendosur. Në Komunën e Shtërpçës është në proces implementimi projektit BE- RRS faza e dytë. Ky projekt zbatohet nga IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrim), Ministria për Komunitete dhe Kthim, UNHCR, ndërsa projekti është financuar kryesisht nga Zyra e Komisionit Evropian. Në periudhën të vitit 2021, gjithsej 5 familje kanë marr ndihmë përmes këtij projekti.

Riatdhesimi: Gjatë periudhës së raportimit Shefi i ZKKK e komunës së Shtërpçës, ka marr kërkesat, ka regjistruar në bazë të dhënave dhe ka përditësuar rregullisht. Sa i përket personave të riatdhesuar në vendet e treta, është ofruar ndihma në vijim:

Gjatë periudhës së raportimit nga shteti i tret janë kthyer 3 persona

Nga të cilët sipas përkatësisë etnike

Shqiptar.....0 familje me.....3 persona

Serb.....0 familje me.....0 persona

Rom..... 0 familje me.....0 persona

Aktivitetet lidhur me integrim për periudhën Janar - Dhjetor 2021:

Janë mbajtur takime komisionit për riintegrimi (KKR)	2
Kërkesa për vazhdim mbështetjes me barna nga Fondi i Riintegritit të MUP-se	0
Kërkesat për vazhdimin e akomodimit, me qira për 8 muaj nga Fondi i MPB-së për Riintegrim	1
Kërkesa për rindërtim të një shtëpie banimi	0
Certifikatat e lëshuara nga ZKKK - Dëshmi për personat e riatdhesuar	10
Fituesit e trajnimit në punë (përmes Zyrës së Punësimit)	0
Të punësuarit përmes programeve të subvencionimit, me pagë në kompanitë private, me 50% të pagës, përmes Zyrës së Punësimit pran Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në tekstin e mëtejme (MPMS) MPB dhe UNDP)	0
Vizitat të përbashkëta, verifikime dhe monitorime të rasteve 2019 - 2020-2021	18
Raste të evidentuara në Zyrën e Punësimit dhe Qendrën për Aftësimin Profesional në Ferizaj	11
Monitorimi i riintegritit të familjeve nga kategoritë e ndihshme (të cënueshme).	7
Monitorimi - Zbatimi i vendimeve të OQR nga viti 2019, 2020, 2021.	3

Kërkesë për paketë dimërore-dru zjarri	0
Fituesit e grantit për vetëpunësim me plan biznesi përmes Zyrës së Punësimit, APRK-MPMS dhe UNDP	0
Zbatimi i vendimeve OKR për një paketë mobilieash e shtëpisë(në pritje)	1

Qasja e komuniteteve në shërbimet komunale: Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka pasur ndonjë vërejtje e drejtuar nga komuniteti, kur është fjala për qasjen e tyre në të gjitha shërbimet në komunë, duke përfshirë edhe shërbimet publike në komunë.

Këshilla për organet ekzekutive komunale dhe autoritetin përfaqësues: Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete sipas nevojave e afron rekomandime, njoftimet për trupin ekzekutiv të komunës dhe zyrat të tjera komunale

